



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 585/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Nehat Idrizi kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër anëtarëve të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Drenas, për shkak të kërcënimit gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e palejuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjekti politik LVV, ne te cilën pretendohet se me datë 12.12.2010, në një qendër votimi në Drenas një person i cili duket në CD voton fletëvotimet e subjektit politik PDK. Sipas parashtruesit të ankesës kjo përbën shkelje ligjore dhe parashtruesi i ankesës kërkon të merren masa për hetim se të gjitha të dhënat që mungojnë për QV nuk mund të evidentohen të jepen për shkak të rrezikimit të vëzhguesve të LVV.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një CD.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 4 paragrafi 2 parasheh:

PZAP-i mund ti hidh poshtë (si të palejuara, të parregullta parregullta apo të pasafatshme) ankesat të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, poashtu PZAP-refuzon ankesat të cilat janë të pabazuar, apo të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e Panelit të Zgjeruar të datës 16.12.2010, Anr. 490/2010. Pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi. PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa

A nr. 585/2010 më datën 16.12.2010.

